



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Drzavna Agencija za Zastitu Licnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr. prot 27/2012
Datë: 22.10.2012

Në mbështetje të nenit 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5.) të Ligjit Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 70/31 maj 2010) Mbikëqyrësi Shtetëror merr këtë:

V E N D I M

1. Këshillohet Komuna e Prishtinës të zgjedhin dhe caktojnë me shkrim një zyrtar të brendshëm për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Të marrë vendim për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë.
3. Regjistri i hyrje - dalje nga ndërtesa e komunës të bëhet konform nenit 69 të Ligjit Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Komuna e Prishtinës, në afat prej 15 ditësh të njoftojë Agjencinë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 (paragrafi 1, 1.4.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejshëm LMDHP), më datë 16.10.2012, Agjencia ka realizuar kontrollin sipas detyrës zyrtare në Komunën e Prishtinës.

Pas kontrollit është përpiluar procesverbali me nr.05/2012, i cili është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës dhe të njëjtit i është dorëzuar një kopje.

Në bazë të kontrollit të bërë, në procesverbal është konstatuar kjo gjendje:

Gjatë kontrollit që është bërë në Komunën e Prishtinës është konstatuar që shkresa e Agjencisë e datës 31 gusht 2012 për caktimin e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale është pranuar nga ana e komunës dhe se kjo shkresë është shqyrtuar dhe janë në procedurë të caktimit të këtij zyrtari, për çka do të njoftohet zyratrisht Agjencia.

Neni 74 i Ligjit Nr.03/L-172 parasheh që të gjitha organet publike që përpunojnë të dhëna personale zgjedhin dhe caktojnë me shkrim një zyrtar të brendshëm për mbrojtjen e të dhënave.

Komuna e Prishtinës ka të instaluar sistemin e vëzhgimit me kamerë, por nuk ka vendim të shkruar për instalimin e sistemit të vëzhgimit. Në nenin 62 (paragrafi 1) thuhet se personat në sektorin publik dhe privat mund të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë për vëzhgimin e ndërtesave të tyre, nëse konsiderohet e nevojshme për sigurinë e njerëzve dhe sigurimin e pasurisë. Vëzhgimi me kamerë, në veçanti, mund të jetë i nevojshëm për të vëzhguar hyrjet e ndërtesave ose ku, për shkak të natyrës së punës së tyre, ekziston kërcënim potencial ndaj të punësuarve.

Në nenin 62 (paragrafi 2 dhe 3) të LMDHP thuhet që vendimet e nevojshme merren nga nëpunësi kompetent, drejtori ose ndonjë person tjetër i autorizuar nga sektori publik ose privat. Vendimi duhet të përmbajë arsyet për vendosjen e sistemeve të vëzhgimit me kamerë.

Gjatë kontrollit është konstatuar se regjistri i hyrje - daljes nga ndërtesa e komunës mbahet rregullisht në një fletore në të cilën merren vetëm disa të dhëna të vizitorëve që hyjnë dhe dalin nga ndërtesa e komunës.

Në nenin 69 (paragrafi 2) i LMDHP parashihet që të dhënat e regjistrimit të personave që hyjnë ose dalin nga ndërtesat mund të përmbajnë vetëm këto të dhëna personale: emrin (at) personal, numrin dhe llojin e dokumentit të identifikimit, adresën e përhershme ose të përkohshme, datën dhe kohën si dhe arsyen për hyrje në ndërtesë.

Siç është përshkruar në arsyetimin e këtij vendimi, bazuar në nenin 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbikëqyrësi shtetëror ka marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë, por mund të hapet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Vendimi i dërgohet:

- Komunës së Prishtinës
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Arkivit të Agjencisë

Adresa: Pejton Rr. Pashko Vasa Nr. 4, 10000 Prishtinë – Kosovë 2

Ramadan Qehaja
Mbikëqyrësi Shtetëror

